

FUNKSIONET E BASHKISE

Funksionet e Bashkise jane dy, **te mandatuara dhe te deleguara.**

1- FUNKSIONET/DETYRAT QË MANDATOHEN

a. Me përjashtim të rastit kur rregulli mbi të cilin bazohet kompetenca e tyre nuk e lejon këtë gjë, Kryetari i Bashkisë mund të mandatojë ushtrimin e një ose me shume kompetencave si dhe nënshkrimin e shkresave për kategori çështjesh të prëcaktuara prej tij dhe nëpunësve të caktuar prej tij.

b. Mandatimi nuk ndodh pa miratimin e nëpunësit përkatës dhe, përsa është e zbatueshme, pa miratimin e drejtorit dhe/ose kreut të njësisë administrative dhe organizative. Kompetenca e mandatuar ushtrohet në emër dhe nën përgjegjësinë e Kryetarit të Bashkisë. Për cdo mandatim hartohen, nëse është e nevojshme, rregulla të mëtejshme.

c. Kryetari i Bashkisë harton vendimin e mandatimit i cili mund të inspektohet nga gjithëkush. Kryetari vë në dijeni Këshillin e Bashkisë për këtë vendim.

2- FUNKSIONET/DETYRAT QË DELEGOHEN

Delegimi mund t'i bëhet një njësie administrative dhe organizative apo një nëpunësi civil.

a. Delegimi, nuk ndodh pa pëlqimin e nëpunësit përkatës dhe për sa gjen zbatim edhe të drejtorit edhe/apo të kreut të tij të njësisë administrative apo organizative.

b. Kryetari i Bashkisë harton vendimin e delegimit i cili mund të inspektohet nga gjithëkush. Kryetari vë në dijeni Këshillin e Bashkisë për këtë vendim.

c. Kompetenca e deleguar ushtrohet në emër dhe përgjegjësi të njësisë organizative ose nëpunësit të cilit i është deleguar kompetenca.

Kompetencat e këshillit të njësisë së qeverisjes vendore janë :

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.

Kompetencat e kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore përfshijne:

Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore propozon drejtimet kryesore të politikës së njësisë së qeverisjes vendore dhe projektbuxhetin në këshillin përkatës të njësisë së qeverisjes vendore.

Funksionet e Bashkisë janë të shumëllojshme duke prekur shumë fusha të ndryshme të zhvillimit të qytetit, funksione këto të cilat sa kanë ardhur edhe janë rritur nga procesi i decentralizimit të pushtetit lokal. Bashkia ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e saj në fushat e mëposhtme:

Infrastruktura dhe Shërbimet Publike:

- *Furnizimi me ujë të pijshëm*
- *Funksionimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të bardha, të ujërave të zeza dhe kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara*
- *Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve me karakter vendor, trotuareve dhe shesheve publike*
- *Ndriçimi i mjediseve publike*
- *Funksionimi i transportit publik urban*
- *Administrimi i varrezave dhe garantimi i shërbimit të varrimit*
- *Shërbimi i dekorit*
- *Administrimi i parqeve, lulishteve dhe zonave të gjelbëruara publike*

- *Grumbullimi, largimi dhe përpunimi i mbeturinave*
- *Planifikimi urban, menaxhimi i tokës dhe strehimi sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.*

Shërbime me Karakter Social, Kulturor e Sportiv:

- *Ruajtja dhe zhvillimi i vlerave kulturore dhe historike vendore, organizimi i veprimtarive dhe administrimi i institucioneve përkatëse*
- *Organizimi i veprimtarive sportive, çlodhëse e argëtuese dhe administrimi i institucioneve përkatëse*
- *Shërbimi social dhe administrimi i institucioneve si: çerdhet, azilet, shtëpitë e fëmijëve, etj.*

Zhvillimi Ekonomik Vendor:

- *Përgatitja e programeve të zhvillimit ekonomik vendor*
- *Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë*
- *Zhvillimi i biznesit të vogël, si dhe zhvillimi i veprimtarive nxitëse si panaire e reklama në vende publike*
- *Organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor si: informacioni, struktura dhe infrastruktura e nevojshme*
- *Shërbimi veterinar*
- *Ruajtja dhe zhvillimi i pyjeve, kullotave e burimeve natyrore me karakter vendor*

Rendi dhe Mbrojtja Civile:

- *Ruajtja e rendit publik për parandalimin e shkeljeve administrative dhe garantimi i zbatimit të akteve të Bashkisë*
- *Mbrojtja civile*

Gjithashtu Bashkia Fier ndan disa detyra dhe përgjegjësi të përbashkëta me pushtetin qendror. Në rastet kur pushteti qendror i kërkon Bashkisë, apo komunës, kryerjen e një funksioni të përbashkët ose arritjen e një standardi kombëtar për realizimin e këtij funksioni, pushteti qendror i siguron mbështetje të mjaftueshme financiare dhe materiale Bashkisë Fier. Bashkia Fier ndan detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme me pushtetin qendror.

- *Arsimin parashkollor dhe parauniversitar*
- *Sistemin e shërbimit parësor shëndetësor dhe mbrojtjen e shëndetit publik*
- *Kujdesin social, zbutjen e varfërisë dhe garantimin e funksionimit të institucioneve përkatëse*
- *Rendin publik dhe mbrojtjen civile*
- *Mbrojtjen e mjedisit*
- *Funksione të tjera të përbashkëta sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.*